

5 KUTITË E MËDHA NDRIÇUESE

1 Ridvan Slivova **Protesta e grave për paqe me letër të bardhë, 8 mars 1998**

Në përgjigje të shpejtë ndaj sulmit të forcave serbe në kompleksin e familjes Jashari në fshatin Prekaz, në rajonin qendror rural të Kosovës, në Drenicë, ku u vra familja e gjerë me 58 anëtarë, kryesisht gra dhe fëmijë, gratë e Kosovës urbane filluan të organizojnë protesta. Kjo protestë e parë kërkonte paqe, me letra të bardha. Gjithsej, rrjeti i grave organizoi 8 nga 13 protestat e mbajtura atë muaj kundër dhunës ushtarake të Millosheviqit në Drenicë. Gratë kërkonin “divorc paqësor” nga Serbia.

Seria e intervistave nga Historia Orale e Kosovës me pjesëmarrëset e këtyre protestave tregon historinë e aktivizimit të grave dhe rezistencës së tyre. Gratë u prekën veçanërisht nga politikat e apartheidit të viteve të '90-ta të regjimit të Millosheviqit. Kur u larguan nga vendet e punës në sektorin publik, vende të cilat kishin ankoruar emancipimin e gruas që nga vitet e '60-ta, gratë e arsimuara profesioniste u kthyen përsëri në rolin e amviseve. Për shumë gra filloi kufizimi social nga vlerat tradicionale mbi të cilat shoqëria shqiptare e Kosovës konsolidoi rezistencën ndaj masave të dhunshme serbe.

<https://oralhistorykosovo.org/sq/march-1998-womens-protests/>

2 Eliza Hoxha **Protestat Studentore, Dragodan/Arbëri, 1997**

Ky është Albin Kurti, tani kryeministër i Kosovës, por atëherë, në fillimet e karrierës së tij politike, lider studentor në vitin 1997, duke organizuar protesta kundër mbylljes së arsimit të lartë dhe shkollave për popullsinë shumicë shqiptare nën sistemin e apartheidit të vendosur nga Millosheviqi në Kosovë pas vitit 1989. Këtu është fotografuar nga Eliza Hoxha, e cila sot është deputete e Kuvendit të Kosovës dhe në atë kohë ishte studente e arkitekturës dhe fotografe për revistën Zëri. Kurti në këtë foto është duke përdorur shpinën e Zenel Kelmendit, rektorit të Universitetit të Prishtinës nga viti 1997 deri në 2004, si mbështetje për të shkruar.

Nga viti 1991 deri 1999, shkollimi i shqiptarëve të Kosovës ishte vetë-organizuar pa mbështetje shtetërore dhe shpeshherë i nënshtrohej sulmeve policore. Shkollimi ishte organizuar në shtëpi private dhe pak ndërtesa të mbetura për të cilat nuk kishte nevojë regjimi i Millosheviqit. Shkollimi ishte mbase shtylla kryesore e lëvizjes së rezistencës civile kundër masave të dhunshme serbe dhe suprimimit të institucioneve të Krahinës Autonome të Kosovës, i zhvilluar në përputhje me kushtetutën e vitit 1974 të Jugosllavisë. Formalisht, Millosheviqi imponoi kurrikulë serbe e cila ishte e papranueshme për shumicën shqiptare; në praktikë, të gjithë nxënësit, studentët dhe mësuesit shqiptarë u përjashtuan nga vendet e tyre në shkollimin shtetëror.

Protestat e herëpashershme të studentëve, të iniciuara në vjeshtën e vitit 1997 dhe shpesh të shpërndara me dhunë nga policia serbe, ishin pikë kthese kyçe në zgjerimin e rezistencës dinamike kundër shtetit policor serb të imponuar, ndërsa të rinjtë humbën durimin me lojën pasive, jokonfrontuese të pritjes që karakterizonte rezistencën paqësore të drejtuar nga Ibrahim Rugova, studiues i letërsisë, i cili disa herë përshkruhej si Gandhi shqiptar. Paraqitja më e detajuar e lëvizjes së rezistencës civile të shqiptarëve të Kosovës është libri e të ndjerit Howard Clark, “Rezistenca Civile në Kosovë” (2000).

<https://www.opendemocracy.net/en/civilresistance/limits-of-prudence-civil-resistance-in-kosovo-199098/>

5 KUTITË E MËDHA NDRIÇUESE

3 **Ridvan Slivova** **Bukë për Drenicën,** **Prishtinë, 16 mars 1998**

Marshi i Grave “Bukë për Drenicën” është më i njohuri nga ata të organizuar në mars të vitit 1998, në të cilin u tregua solidaritet me popullin e rrethuar të rajonit të Drenicës, të cilët ishin të privuar nga qasja në ushqim dhe furnizime mjekësore, nga prania e vazhdueshme e ushtrisë serbe pas sulmit të përgjakshëm në kompleksin e familjes Jashari në fshatin Prekaz të Drenicës.

Protesta, në të cilën gratë synonin të marshonin nga Prishtina në Drenicë, të gjitha duke mbajtur simbolikisht nga një bukë, u ndalua nga policia serbe në Fushë Kosovë, disa kilometra në perëndim të Prishtinës. Ndonëse nuk u lejua arritja e tyre në destinacionin e tyre final, u përçua mesazhi i tyre politik dhe humanitar. Protestat e organizuara nga aktivistet gra gjatë gjithë muajit mars të vitit 1998 patën ndikim të madh, duke sjellë më shumë vizibilitet ndërkombëtar për dhunën që ndodhte në Drenicë.

Shih videon e protestës këtu: <https://www.youtube.com/watch?v=bAEjiONutCM&t=100s>

Për t'i dëgjuar dëshmitë e grave që morën pjesë në këtë protestë, shih <https://oralhistorykosovo.org/podcast/bread-for-drenica-womens-march/>

4 **Alan Chin** **Nëna e Ali Paqarizit qan mbi trupin e tij në Kosovë,** **New York Times, 1998**

Kjo fotografi u ekspozua në Muzeun e Artit Modern, MoMA, në Nju Jork, në vitin 2001. Ajo tregon vajtimin për Ali Paqarizin, 19-vjeçari shqiptar i vrarë nga kurthi shpërthyes serb. Kjo fotografi duket se pasqyron kompozimin e një pikturë nga një prej mjeshtrave të vjetër.

“Ishte skenë shumë e trishtuar dhe tragjike. Megjithatë, familja na mirëpriti ne gazetarëve në dhomë sepse, e marr mend, donin që humbja e tyre të incizohej dhe të kujtohej. Drita nga dritarja ishte e shpërndarë përmes një perdeje të bardhë, duke krijuar një dritë të bukur”, tha Chin në një postim të fundit.

Michael Kimmelman, në atë kohë kritik kryesor i artit në The New York Times, shkroi se fotoja paraqet “... jo funeralin formal ushtarak të Paqarizit, por atë që ndodhi atë ditë në dhomën e ndjenjës së familjes së tij, ku nëna e tij, e rrethuar nga gra të pikëlluara, vajtonte mbi trupin e djalit të saj. Fotografia kap jo shfaqjen publike të kundërshtimit politik, por rrënjën e saj: dëshpërimin privat që është pasojë e luftës.”

5

Hazir Reka

Tubimi i Minatorëve, Pallati i Rinisë “Boro dhe Ramizi”, salla e madhe, shkurt 1988

Tubimi i Minatorëve, Pallati i Rinisë “Boro dhe Ramizi”, salla e madhe, shkurt 1988

Kjo është një fotografi e rrallë nga njëra prej një sërë tubimesh që i kanë paraprirë protestës së minatorëve të Kosovës. Në nëntor të vitit 1988, 3000 minatorë të Trepçës marshuan 50 kilometra deri në Prishtinë (miniera e Trepçës është afër Mitrovicës), duke frymëzuar deri në 300,000 kosovarë të tjerë për të bërë marshime në solidaritet, dhe në shkurt të vitit 1989 rreth 7000 minatorë u futën në grevë brenda minierave në të gjithë Kosovën për gati një javë, duke formuar vijën e parë të një greve të përgjithshme të Kosovës.

Shfaqja e portretit të Titos nga minatorët, gjë që më vonë e bënë edhe marshuesit e nëntorit 1988 në krye të kolonës së tyre, epitomizon ankesat e tyre: në mbrojtje të Jugosllavisë dhe kundër shpërbërjes me forcë të autonomisë së Kosovës, e cila u vendos në kushtetutën e Titos të vitit 1974. Shikoni videon arkivore të RTK-së të kësaj greve në ekspozitën “Reporting House”, ku minatorët deklaruan se duan që shqiptarët të kenë të njëjtat të drejta në Jugosllavi sikurse kombësitë e tjera (kushtetuta e vitit 1974 i dha Kosovës të njëjtat institucione si ato të republikave jugosllave dhe statusin e njësisë federale, por nominalisht e mbajti atë brenda Republikës së Serbisë).

Marshi i minatorëve protestoi kundër shkarkimit të liderëve krahinorë të Kosovës, Azem Vllasi dhe Kaqusha Jashari, dhe zëvendësimin e tyre me njerëz të besuar të Millosheviqit. Greva me ulje tentoi të parandalojë lëvizjet e fundit kundër autonomisë së Kosovës dhe kërkoi dorëheqjen e njerëzve të besuar. Greva u ndërpre pasi 180 minatorë u hospitalizuan për shkak të kushteve të ashpra brenda minierave dhe njerëzit e besuar u shkarkuan formalisht, por u rikthyen dhe gjendja emergjente u shpall 2 ditë pasi minatorët dolën nga nëntoka, në dritë pas fitores së shkurtër.

Deri në vitin 1992, 94% e minatorëve shqiptarë të Kosovës u pushuan nga puna. Zhvillimi i një klase punëtore industriale ishte për shqiptarët e Kosovës simbol kyç i modernitetit që u hap si mundësi për ta nën autonominë e krahinës në periudhën e fundit të Titos. Humbja e papritur e kësaj, karshi largimeve masive ishte tronditje e dyfishtë. Kjo këngë, “Baba im”, nga grupi Minatori dhe video shoqëruese paraqesin vajtimin për këtë modernitet të rrëmbyer:

<https://www.youtube.com/watch?v=BZQ0VsSpy8o>

REPORTING HOUSE

KUTITË E VOGLA NDRIÇUESE

• KUTIA NDRIÇUESE 1

FËMIJËT NË LUFTË 1999

- | | |
|--------------------------------|------------------------------|
| 1. Eliza Hoxha (Zëri): | Djaloshi përshëndet ushtarin |
| 2. Alan Chin (New York Times): | Djali i vogël, tanku i madh |
| 3. Eliza Hoxha (Zëri): | Hi five |

• KUTIA NDRIÇUESE 2

KËMBËZBATHUR 1986

4. Iljaz Bylykbashi (Rilindja) Shkolla në Sllovi, Komuna e Lipjanit.

Nxënësit janë urdhëruar të kenë këpucë shtesë për sallën e brendshme meqë shumica vinin me këpucë me baltë, duke ecur nga fshatrat e afërta që nuk kishin rrugë të asfaltuara. Shumica e nxënësve qëndruan zbathur meqë nuk kishin kushte për të blerë këpucë të tjera.

5. Iljaz Bylykbashi, Shkolla e Fshatit Sllovi, Lipjan

6. Iljaz Bylykbashi, Shkolla e Fshatit Sllovi, Lipjan

• KUTIA NDRIÇUESE 3

FËMIJËT NË LUFTË 1997-1999

- | | |
|--------------------------------|--|
| 7. Ilaz Bylykbashi (Rilindja): | Shtëpitë-shkolla të nëntokës në sistemin paralel të arsimit të shqiptarëve të Kosovës |
| 8. Ilaz Bylykbashi (Rilindja): | Shkollat e nëntokës për fëmijët e shqiptarët e Kosovës |
| 9. Alan Chin (New York Times): | Vushtrri, Kosovë, 24 qershor 1999.
Shqiptarët e Kosovës djegin dhe plaçkisin një lagje serbe në Vushtrri. Ushtarët francezë të KFOR-it kurrë nuk arritën në vend të ngjarjes. |

• KUTIA NDRIÇUESE 4

FËMIJË NË LUFTË, mars-qershor 1999

10. Andrew Testa (New York Times): Djaloshi në fotografi është Petrit Halilaj, duke pritur në radhë për ndihma humanitare. Ai më vonë u bë një prej artistëve më të njohur bashkëkohorë të Kosovës dhe ka hapur ekspozitë në Muzeun Metropolitan të Arteve, MET, në New York.
11. Paul Lowe (Telegraph magazine & NYT): Gruaja me foshnjë në kamp refugjatësh
12. Paul Lowe (Telegraph magazine & NYT): Radha për bukë

- KUTIA NDRIÇUESE 5

VAJZAT NË LUFTË 1997-1998

- 13. Alan Chin (New York Times): Vajza dhe gjyshi
- 14. Alan Chin (New York Times): Vajza nën batanije
- 15. Alan Chin (New York Times): Fshatarët e zhvendosur në pyje duke pushuar

- KUTIA NDRIÇUESE 6

DJEMTË NË LUFTË 1999

- 16. Alan Chin (New York Times): Djem të rreptë
- 17. Paul Lowe (New York Times): Djaloshi i zhvendosur i dërrmuar
- 18. Andrew Testa: Një i ri shqiptar i raskapitur fle në pyll, në të cilin ai dhe anëtarët e familjes së tij janë fshehur pasi forcat serbe sulmuan fshatin e tij

- KUTIA NDRIÇUESE 7

ADOLESHENTËT NË LUFTË 1998

- 19. Alan Chin (New York Times): Fëmijët në traktor
- 20. Alan Chin (New York Times): Gratë e shqetësuara në hekurudhë
- 21. Alan Chin (New York Times): Refugjati i mërzitur, i mbështetur në gardh

• KUTIA NDRIÇUESE 8

HELMIMET E SUPUZUARA NË SHKOLLA

Në vitin 1990, përgjatë disa ditëve, duke filluar nga 20-marsi, disa mijëra nxënës të shkollave në Kosovë u goditën nga një sëmundje misterioze. Rastet e para u shfaqën në një shkollë në Podujevë, ku nxënësit alivanoseshin dhe kishin vështirësi me frymëmarrje, ndërsa kishte raportime të ndryshme për një erë të çuditshme ose një pluhur të bardhë mbi bankat e shkollës. Rastet më pas u shtuan, duke prekur pothuajse ekskluzivisht fëmijët shqiptarë të Kosovës, të cilët u transportuan nga prindër të frikësuar dhe të dëshpëruar në radhë makinash drejt spitalit kryesor krahinor në Prishtinë nga e tërë Kosova.

Simptomat përfshinin vjellje, nderze të syve, frymëmarrje të rënduar, pasuar me marramendje, dhimbje barku, konvulsione, rrahje të shpejta të zemrës, halucinacione. Mjekët shqiptarë të Kosovës konkluduan paraprakisht se shkak ishte helmimi. Një valë sulmesh vigjilante ndaj serbëve dhe malazezëve të dyshuar si helmues u raportuan nëpër Kosovë. Zyrtarët dhe vëzhguesit serbë e shpërfillën këtë sëmundje duke thënë se ishte maskaradë, të indinjuar nga akuza e ngritur ndaj serbëve për krim monstruoz kundër fëmijëve. Disa mjekë serbë fajësuan mjekët shqiptarë për administrimin e ilaçeve tek fëmijët e shëndetshëm dhe policia ndërhyri në së paku një klinikë të drejtuar nga murgeshat, duke arrestuar infermieret dhe duke i larguar pacientët. Mostrat e gjakut dhe urinës u morën për t'u dërguar për analiza në Beograd, ku nuk u raportua të jetë gjetur ndonjë gjurmë helmimi.

Për shqiptarët e Kosovës, ky fenomen ndodhi mes shkatërrimit të autonomisë së Kosovës nga Millosheviqi dhe dukej se shtonte sulmin e përgjithshëm ndaj mirëqenies së tyre. Disa madje e panë atë si provokim të qëllimshëm ndaj shqiptarëve të Kosovës për të ngritur rebelim vetëvrasës, duke ju dhënë mundësinë për pastrimin e tyre të plotë etnik nga territori. Mosbesimi ndaj konkluzioneve të testeve të Beogradit u shtua pas përjashtimit të çdo pjesëmarrjeje të shqiptarëve ose ndërkombëtarëve. Më vonë, disa ekspertë të huaj kryen teste. Ndërsa shumica nuk nxorën rezultat të prerë, një shkencëtar kontravers belg raportoi në vitin 1992 të ketë gjetur gjurmë të gazit nervor në mostra.

Më vonë gjatë vitit 1990 pati shpërthime të tjera të vogla të sëmundjes. Nuk duket të jetë kryer ndonjë monitorim sistematik afatgjatë i rreth 7,400 rasteve. Është thënë se janë qetësuar me kalimin e kohës. Në periudhën e ndërmjetme, epidemia e mosbesimit ndëretnik e nxitur nga helmimet e supozuara shërbeu për të çimentuar ndarjen e shqiptarëve të Kosovës nga sistemi shtetëror i kujdesit shëndetësor dhe arsimit. Shumë shqiptarë të Kosovës më pas kishin frikë t'i çonin fëmijët e tyre për imunizime, duke rezultuar në rritje të poliomielitit dhe sëmundjeve të tjera infektive.

Ndonëse nuk kishte përfundim të qartë, sëmundja masive duket të ketë ngjashmëri me një numër rastesh të tjera të regjistruara në mbarë botën gjatë kësaj kohe, duke përfshirë mijëra vajza shkollë që u sëmurën në Iran me simptoma të ngjashme për disa muaj, disa prej të cilave raportonin erëra të çuditshme ose të kenë parë objekte të çuditshme të hedhura në oborret e shkollës para se të sëmureshin, duke filluar në nëntor 2022. Ashtu sikurse në Kosovë në vitin 1990 dhe epidemi të ngjashme që prekën fëmijët dhe adoleshentët në shkollat e vajzave në Afganistan në vitin 2009 dhe deri në një mijë vajza adoleshente në Bregun Perëndimor të okupuar në vitin 1983, konsensusi shkencor ka filluar t'i grupojë ato në klasifikimin e sëmundjeve psikosomatike: sëmundje psikosomatike që priren të prekin kryesisht vajzat adoleshente në situata të stresit social. Asesi të fabrikuara, por pa një shkak të drejtpërdrejtë fizik, në të njëjtën linjë me PTSD dhe tronditjen nga granatimet.

Një eksplorim i detajuar i këtij episodi është përfshirë në librin e Julie Mertus "Kosova: Si e filluan luftën mitet dhe të vërtetat", 1999. Një përmbledhje e mirë e asaj që mjekët shqiptarë të Kosovës, mjekët serbë dhe mjekët e huaj kishin për të thënë është mbledhur në Wikipedia.

https://en.wikipedia.org/wiki/Kosovo_student_poisoning.

- **LIGHT BOX 8**

HELMIMET E SUPUZUARA NË SHKOLLA

- 22. Ilaz Bylykbashi (Rilindja): Prindërit çojnë fëmijët e tyre në spital
- 23. Ilaz Bylykbashi (Rilindja): Fëmijët e helmuar
- 24. Ilaz Bylykbashi (Rilindja): Oborri i spitalit gjatë furisë së helmimeve

- **KUTIA NDRIÇUESE 9**

FOTOGRAFËT NË LUFTË

- 25. Besnik Mehmeti: autoportret 1999
- 26. Ilaz Bylykbashi: autoportret 1999
- 27. Ilaz Bylykbashi: Tarzan 1996

- **KUTIA NDRIÇUESE 10**

VASKAT, prill 1999

- 28. Paul Lowe (Telegraph magazine & NYT): Vajza me krehër
- 29. Alan Chin (New York Times): Parukeria
- 30. Paul Lowe (Telegraph magazine & NYT): Gati për pedikyr

- **KUTIA NDRIÇUESE 11**

MAD MAX, 1999

- 31. Besnik Mehmeti: Rrota e karrocës
- 32. Besnik Mehmeti: Ushtari në biçikletë
- 33. Besnik Mehmeti: Vetura në luftë

- **KUTIA NDRIÇUESE 12**

USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS NË NGRICË, 1998

- 34. Alan Chin (New York Times): Ushtari në të bardhë
- 35. Alan Chin (New York Times): Lufta në dimër
- 36. Alan Chin (New York Times): Ushtari në të bardhë 2

- **KUTIA NDRIÇUESE 13**

Lajmet Flash, RILINDJA, 1990

- 37. Ilaz Bylykbashi (Rilindja): Shtandi i lajmeve pranë Shtypshkronjës “Rilindja”, tani ndërtesë ministrore
- 38. Ilaz Bylykbashi (Rilindja): Takim i redaksisë së Rilindjes para mbylljes së gazetës së përditshme në shqip nga policia serbe, 1990
- 39. Ilaz Bylykbashi (Rilindja): Dritat e Rilindjes fiken, 1990

KUTITË E VOGLA NDRIÇUESE KOLONA I

- KUTIA NDRIÇUESE 14

SPORTET E KOSOVËS NË TË 1980-at

- 40. Ilaz Bylykbashi (Rilindja): Fadil Vokrri, futbollisti më i famshëm në Kosovë
- 41. Ilaz Bylykbashi (Rilindja): “E duam Prishtinën” në stadium
- 42. Ilaz Bylykbashi (Rilindja): Sportet tradicionale në Opojë, në rajonin e Dragashit

- KUTIA NDRIÇUESE 15

TË MOSHUARIT NË LUFTË, 1999

- 43. Paul Lowe (Telegraph magazine & NYT): Kur të lëshojnë këmbët
- 44. Alan Chin (New York Times): Gjyshja
- 45. Alan Chin (New York Times): Gratë duke vajtuar

- KUTIA NDRIÇUESE 16

SERBIA NË LUFTË, 1998

- 46. Alan Chin (New York Times): Funeral serb
- 47. Andrew Testa (New York Times): Polici serb i vrarë në pritën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, 10 km në perëndim të Prishtinës
- 48. Alan Chin (New York Times): Funeral

REPORTING HOUSE

KUTITË E VOGLA NDRIÇUESE KOLONA II

• KUTIA NDRIÇUESE 1

POLICIA DHE FËMIJËT, 1998 & 1999

- 49.** Andrew Testa (New York Times): Një ushtar serb ruan fshatarët e zhvendosur shqiptarë në Kosovën jugore
- 50.** Eliza Hoxha (Zeri): Djemtë duke i shikuar tanket
- 51.** Andrew Testa (New York Times): Fëmijë më shumë se plumba në Prishtinë

• KUTIA NDRIÇUESE 2

LOJËRAT E URISË, mars-qershor 1999

- 52.** Besnik Mehmeti: Rrëshqitëse verore
- 53.** Besnik Mehmeti: Ushqim për familjen
- 54.** Besnik Mehmeti: Përgatitje për drekë

• KUTIA NDRIÇUESE 3

LUFTA MBAROI

- 55.** Eliza Hoxha, 2000: Tabela e zezë
- 56.** Eliza Hoxha, 2000: Vajzat në kopsht
- 57.** Eliza Hoxha, 2000: Djalë i zhytur në mendime

• KUTIA NDRIÇUESE 4

KAMP I DETYRUAR, 1998

- 58.** Eliza Hoxha (Zeri): Shtëpi
- 59.** Iliaz Bylykbashi (Rilindja): Shkollat në tenda
- 60.** Iliaz Bylykbashi (Rilindja): Mësimi jashtë

• KUTIA NDRIÇUESE 5

DJEMTË NË LUFTË, 1998

- 61.** Alan Chin (New York Times): Vetëm lajme, pa muzikë
- 62.** Alan Chin (New York Times): Turma në kampin e refugjatëve
- 63.** Alan Chin (New York Times): Të mërzitur në luftë

- **KUTIA NDRIÇUESE 6**

TË RINJTË NË LUFTË, 1999

- 64. Alan Chin (New York Times): Koha e drekës
- 65. Alan Chin (New York Times): Racionet ditore
- 66. Alan Chin (New York Times): Kapelat e ngrohta

- **LIGHT BOX 7**

HELMIMET E SUPUZUARA NË SHKOLLA 1990

Në vitin 1990, përgjatë disa ditëve, duke filluar nga 20-marsi, disa mijëra nxënës të shkollave në Kosovë u goditën nga një sëmundje misterioze. Rastet e para u shfaqën në një shkollë në Podujevë, ku nxënësit alivanoseshin dhe kishin vështirësi me frymëmarrje, ndërsa kishte raportime të ndryshme për një erë të çuditshme ose një pluhur të bardhë mbi bankat e shkollës. Rastet më pas u shtuan, duke prekur pothuajse ekskluzivisht fëmijët shqiptarë të Kosovës, të cilët u transportuan nga prindër të frikësuar dhe të dëshpëruar në radhë makinash drejt spitalit kryesor krahinor në Prishtinë nga e tërë Kosova.

Simptomat përfshinin vjellje, nderje të syve, frymëmarrje të rënduar, pasuar me marramendje, dhimbje barku, konvulsione, rrahje të shpejta të zemrës, halucinacione. Mjekët shqiptarë të Kosovës konkluduan paraprakisht se shkak ishte helmimi. Një valë sulmesh vigjilante ndaj serbëve dhe malazezëve të dyshuar si helmues u raportuan nëpër Kosovë. Zyrtarët dhe vëzhguesit serbë e shpërfillën këtë sëmundje duke thënë se ishte maskaradë, të indinjuar nga akuza e ngritur ndaj serbëve për krim monstruoz kundër fëmijëve. Disa mjekë serbë fajësuan mjekët shqiptarë për administrimin e ilaçeve tek fëmijët e shëndetshëm dhe policia ndërhyri në së paku një klinikë të drejtuar nga murgeshat, duke arrestuar infermieret dhe duke i larguar pacientët. Mostrat e gjakut dhe urinës u morën për t'u dërguar për analiza në Beograd, ku nuk u raportua të jetë gjetur ndonjë gjurmë helmimi.

Për shqiptarët e Kosovës, ky fenomen ndodhi mes shkatërrimit të autonomisë së Kosovës nga Millosheviqi dhe duke se shtonte sulmin e përgjithshëm ndaj mirëqenies së tyre. Disa madje e panë atë si provokim të qëllimshëm ndaj shqiptarëve të Kosovës për të ngritur rebelim vetëvrasës, duke ju dhënë mundësinë për pastrimin e tyre të plotë etnik nga territori. Mosbesimi ndaj konkluzioneve të testeve të Beogradit u shtua pas përjashtimit të çdo pjesëmarrjeje të shqiptarëve ose ndërkombëtarëve. Më vonë, disa ekspertë të huaj kryen teste. Ndërsa shumica nuk nxorën rezultat të prerë, një shkencëtar kontravers belg raportoi në vitin 1992 të ketë gjetur gjurmë të gazit nervor në mostra.

Më vonë gjatë vitit 1990 pati shpërthime të tjera të vogla të sëmundjes. Nuk duket të jetë kryer ndonjë monitorim sistematik afatgjatë i rreth 7,400 rasteve. Është thënë se janë qetësuar me kalimin e kohës. Në periudhën e ndërmjetme, epidemia e mosbesimit ndëretnik e nxitur nga helmimet e supozuara shërbeu për të çimentuar ndarjen e shqiptarëve të Kosovës nga sistemi shtetëror i kujdesit shëndetësor dhe arsimit. Shumë shqiptarë të Kosovës më pas kishin frikë t'i çonin fëmijët e tyre për imunizime, duke rezultuar në rritje të poliomielitit dhe sëmundjeve të tjera infektive.

Ndonëse nuk kishte përfundim të qartë, sëmundja masive duket të ketë ngjashmëri me një numër rastesh të tjera të regjistruara në mbarë botën gjatë kësaj kohe, duke përfshirë mijëra vajza shkollë që u sëmurën në Iran me simptoma të ngjashme për disa muaj, disa prej të cilave raportonin erëra të çuditshme ose të kenë parë objekte të çuditshme të hedhura në oborret e shkollës para se të sëmureshin, duke filluar në nëntor 2022. Ashtu sikurse në Kosovë në vitin 1990 dhe epidemi të ngjashme që prekën fëmijët dhe adoleshentët në shkollat e vajzave në Afganistan në vitin 2009 dhe deri në një mijë vajza adoleshente në Bregun Perëndimor të okupuar në vitin 1983, konsensusi shkencor ka filluar t'i grupojë ato në klasifikimin e sëmundjeve psikosomatike: sëmundje psikosomatike që priren të prekin kryesisht vajzat adoleshente në situata të stresit social. Asesi të fabrikuar, por pa një shkak të drejtpërdrejtë fizik, në të njëjtën linjë me PTSD dhe tronditjen nga granatimet.

Një eksplorim i detajuar i këtij episodi është përfshirë në librin e Julie Mertus "Kosova: Si e filluan luftën mitet dhe të vërtetat", 1999. Një përmbledhje e mirë e asaj që mjekët shqiptarë të Kosovës, mjekët serbë dhe mjekët e huaj kishin për të thënë është mbledhur në Wikipedia.

https://en.wikipedia.org/wiki/Kosovo_student_poisoning.

- KUTIA NDRIÇUESE 7

HELMIMET E SUPUZUARA NË SHKOLLA 1990

- | | |
|----------------------|--------------------------------|
| 67. Ilaz Bylykbashi: | Të rriturit mbajnë fëmijët |
| 68. Ilaz Bylykbashi: | Panik në spital gjatë helmimit |
| 69. Ilaz Bylykbashi: | Policia para spitalit |

- KUTIA NDRIÇUESE 8

SHKRIMTARËT NË LUFTË

- | | |
|---------------------------------|--|
| 70. Besnik Mehmeti: | Rexhep Qosja, Shkrimtar shqiptar i Kosovës i maskuar si refugjat, 1999 |
| 71. Ilaz Bylykbashi (Rilindja): | Ibrahim Rugova & Adem Demaçi, Shkrimtarët e Kosovës që u bënë politikanë, 1995 |
| 72. Ilaz Bylykbashi (Rilindja): | Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptarë, që u bë Qendra për Informim e Kosovës, QIK, 1992 |

- KUTIA NDRIÇUESE 9

MAD MAX, 1999

- | | |
|--------------------------------------|------------------|
| 73. Besnik Mehmeti: | Kthimi në shtëpi |
| 74. Alan Chin (New York Times): | Në shtëpi me çdo |
| 75. Besnik Mehmeti (New York Times): | Tour de Kosovo |

- KUTIA NDRIÇUESE 10

LUFTA KALONI NËPËR SHTËPI, 1999

- | | |
|---------------------|--------------------------------------|
| 76. Besnik Mehmeti: | Hiri në qytetin e vjetër të Gjakovës |
| 77. Besnik Mehmeti: | Qarshia e djegur, e rinovuar më vonë |
| 78. Besnik Mehmeti: | Shtëpi |

- KUTIA NDRIÇUESE 11

SERBIA në luftë

79. Andrew Testa: Motra Anjelica, Manastiri Ortodoks Serb i Devicit. Thellë në territorin e UÇK-së, manastiri i mbijetoi luftës, por u shkatërrua në trazirat anti-serbe në 2004.

80. Thomas Dworzak (Magnum): “Arkan”, Željko Ražnatović, pas ndeshjes. Kryekomandanti serb dhe menaxheri i klubit të futbollit “Obiliq” të Prishtinës, mars 1999.

81. Andrew Testa: Varrimi i Dobrivoje Savaliqit, civilit serb 42-vjeçar i rrëmbyer nga fshati Hoçë e Madhe dhe i vrarë nga UÇK-ja.

- KUTIA NDRIÇUESE 12

KTHIMI

82. Andrew Testa (New York Times): Ushtarët e maskuar serbë largohen nga Kosova pas kapitullimit të Serbisë, Ben Brown shor 1999

83. Andrew Testa (New York Times): Refugjatët nga Kosova presin në autobusë për të hyrë në kampin e refugjatëve në Radushë, Maqedoni, 16 prill 1999

84. Alan Chin (New York Times): Hetuesit gjejnë eshtra nga vrasjet në Kosovë

- KUTIA NDRIÇUESE 13

TË MOSHUARIT NË LUFTË

85. Alan Chin (New York Times): Me traktor në shtëpi

86. Paul Lowe (Telegraph magazine & NYT): Duke i bartur të moshuarit

87. Alan Chin (New York Times): Refugjatët nën çarçafë